



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Begzad Sinani, Kryetar i Komunës së Kamenicës Bajram Dërmaku, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamenti Ligjor dhe i Monitorimit të Komunave/ MAPL	
Përmes:	Mirjana Jevtić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së.	
Nga:	Shkëlqim Jakupi, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 11/04/2017
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Kamenicës	020/542
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01-16855 për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër me qira të pronës së paluajtshme të komunës personave fizik dhe juridik duke pasur parasysh interesin publik komunal-Kamenicë
E miratuar më datë më datë: 30.03.2017
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.04.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Begzad Sinani, gradonačelnik opštine Kamenica Bajram Dërmaku, predsedavajući Skupštine opštine Kamenica
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u u opštini Zakonsko odeljenje i monitorisanje opština /MALS
Preko: ZA: BADRAM GECAD	Mirjana Jevtić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a
Od:	Shkëlqim Jakupi, v.d rukovodioca zakonskog Odeljejna i monitorisanje opština, MALS
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Kamenica
Vrsta akata:	Odluka

Datum:
11/04/2017
020/542

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opština i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 01 -16855 za davanje na kratkotrajno korišćenje nepokretne opštinske imovine pod kirijom fizičkim i pravnim osobama imajući u vidu javni interes opštine Kamenica.
Usvojena dana, 30.03.2017 godine
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 05.04.2017 godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon rasprave sadržaja gorenavedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova sh.
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Nr. i faq. 01 Br. 16855
Data: 05/04
Br. str. 1 Datum: 2017
KAMENICË/A



Kuvendi Komunal-Kamenicë
ME:03.04.2017

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 shkronja d), nenit 14, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 3 paragrafi 1.1 dhe 1.3 dhe nenit 5 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për Dhënen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtëshme të Komunës, nenit 4 të Rregullres QRK nr. 23/2013 si dhe nenit 7.2 pika b. të Statutit të Komunës së Kamenicës nr. 002/2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më: 30.03.2017 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIË NË SHFRYTËZIM AFATËSHKURTËR ME QIRA TË PRONËS SË PALUAJTËSHME TË KOMUNËS - PËRSONAV FIZIK DHE JURIDIK DUKE PASUR PARASYSHË INTERESIN PUBLIK KOMUNAL -KAMENICË.

I

IPET në shfrytëzim afatëshkurtër-me qira prej pesëmbdhjet (15) vite e cila realizohet përmes konkurimit dhe ankandit publik, Prona e Paluajtëshme Komunale -përsonave fizik dhe juridik për zhvillimin e biznesit- objektit për rekreacion- ndërtimi i Ski liftit, Teleferiku dhe objekte përcjellëse duke pasur parasysh arësytet dhe interesin publik komunal.

II

Pjesa e pronës së dhënë në shfrytëzim me qira afatëshkurtër prej 15 viteve duhet të realizohet përmes konkurrencës së hapur dhe ankandit publik, dhe të jetë e harmonizuar me Planin Zhvillimor të Komunës. Prona është e përshkruar në Certifikatën mbi të Drejtat Pronësore: - P-71107063-00051-0, me një sipërfaqe prej 10 ha (100000 m²), e cila në Zyrën Komunale Kadastrale në Kamenicë evidencohet në emër të P.SH. Kuvendi Komunal-Kamenicë për Z.K.Poliqkë.

III

Për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me qira të pronës së paluajtëshme të Komunës me- afatëshkurtër do të procedojë Komisioni vlerësues, i miratuar nga Kuvendi Komunal.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, i cili do të hartoi kontratën për të drejtën e shfrytëzimit, kurse implementimin do të e bëjnë në bashkëpunim Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria për Pronësi Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Financa dhe Buxhet dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat-Kamenicë.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas ditës së protokolimit në zyrën e Protokolit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi i'u dërgohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, MAPL-së, Komisionit komunal për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim, DPGJK-së, DUPH-së dhe QSHQK-së.



HYRËSE- ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data 05.04.2017
Datum

Nr. lista organizatave	Nr. i Lendës	Shifra	Vlera
1	010-592		